



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**KOSOVA
DEMOCRATIC
INSTITUTE**

**TRANSPARENCY
INTERNATIONAL
KOSOVA**

RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT

**Për komunën e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit,
Podujevës dhe Istogut**

Prill 2020



TRANSPARENCA DHE
KUNDËR-KORRUPSIONI



RAPORTI I MONITORIMIT TË PROKURIMIT

**Për komunën e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit,
Podujevës dhe Istogut**



COPYRIGHT © 2020. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45, 10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Përgatiti: Diana Metushi Krasniqi

Asistentë të hulumtimit: Abedin Imami, Bekim Krasniqi, Erolina Morina dhe Shpend Sopa

Layout and Design: Envinion

Ky publikim është përgatitur nga Instituti Demokratik i Kosovës - Transparency International Kosova dhe përkrahur nga USAID përmes aktivitetit të Komunave Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM). Pikëpamjet e autorit të shprehura në këtë publikim nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE:	6
HYRJE	7
GJETJET KRYESORE	8
METODOLOGJIA	10
ANALIZA E TENDERËVE:	12
KOMUNA E PRIZRENIT	12
Tenderi për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në fshatin Gjonaj të Prizrenit	12
Tenderi për furnizim me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit	13
KOMUNA E SUHAREKËS	15
Tenderi për ndërtimin e rrugëve lokale në Komunë të Suharekës	15
Tenderi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit në Komunë të Suharekës	17
KOMUNA E FERIZAJT	18
Tenderi për asfaltimin e rrugicave në fshatin Tërn të komunës së Ferizajt	19
Tenderi për sigurimin fizik të objektit të Komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të komunës së Ferizajt	20
KOMUNA E LIPJANIT	22
Tenderi për asfaltimin e rrugës Gadime e Epërme – Gllavicë në Komunën e Lipjanit	23
Tenderi për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë Sociale, arkivit të qytetit, shtëpisë së kulturës dhe shtëpisë së komuniteteve në Komunën e Lipjanit	24
KOMUNA E PODUJEVËS	30
Tenderi për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Shajkovc, Batllavë, Svegël, Ballovc, Lladovc, Livadicë dhe Surkish në Komunën e Podujevës	30
Tenderi për ndërtimin e serave për fermer në Komunë të Podujevës	32
KOMUNA E ISTOGUT	33
Tenderi për ndërtimin e rrugëve Hul Huli (Istog i Poshtëm), ndërtimi i rrugës Ibrahim Salihu Tomoc Kovrage, dhe asfaltimin e rrugës në lagjen Dekaj (Istog i Poshtëm) në Komunën e Istogut	33
Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të rendit të IV-të në Komunën e Istogut	35
KONKLuzion	36
REKOMANDIMET	38

LISTA E SHKURTESAVE:

AK - Autoritet Kontraktues

DT - Dosja e Tenderit

EV - Ekovizioni

ISDY - Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë

KDI - Instituti Demokratik i Kosovës

KK - Kuvendi Komunal

KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

LPP - Ligji i Prokurimit Publik

OE - Operator Ekonomik

OJQ - Organizata Jo-Qeveritare

OSHP - Organi Shqyrtues i Prokurimit

RrUOPP - Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik

SV - Syri i Vizionit

YAHR - Asociacioni i të Rinjve për të Drejtat e Njeriut

HYRJJE

Prokurimi publik, si një aktivitet përmes të cilit shpenzohen rreth 40% e buxhetit të Kosovës, vazhdon të jetë ndër sektorët më të përfolur të administratës publike. Përmes këtij procesi blihen mallra, shërbime e punë nga qeveritë dhe ndërmarrjet publike. Lajme e raporte të shumta për keqpërdorime dhe keqmenaxhime me paranë publike e bëjnë atë edhe më të ndjeshëm si ndaj publikut, po ashtu edhe ndaj strukturave udhëheqëse dhe komunitetit të donatorëve. Kjo ka bërë që ky sektor, sidomos në nivel qendror, të jetë mjaft i monitoruar, duke rezultuar në një mbikëqyrje më të ulët në nivel lokal.

Në vazhdim, për shkak të kompleksitetit të veprimtarisë, e cila lidhet ngusht me mjedisin ekonomik gjithmonë në ndryshim, politikat e drejtuara nga ligje të ndryshme vendore, evropiane dhe në nivel global, e bëjnë këtë sektor që të bartë mbi vete edhe një presion të madh drejt përmirësimit të praktikave aktuale.

Me qëllim të monitorimit të këtij procesi, se sa është në harmoni me legjislacionin zhvillimi i procesit të tenderimit në nivel komunal, koalicioni i Organizatave Jo-qeveritare (OJQ), i përbërë nga Asociacioni i të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YAHR), Instituti për Qëndrueshmëri dhe Zhvillim të Rinisë (ISDY), Syri i Vizionit, Ekovizioni (EV) dhe Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), gjatë 2019 kanë monitoruar dhe analizuar 12 tenderë të shpallur nga komunat e Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut. Raporti në vijim paraqet gjetjet nga procesi i tenderimit në gjashtë komunat e sipër cekura, pajtueshmërinë ligjore, dhe praktikat e mira në këtë proces.

GJETJET KRYESORE

1 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përm-bushje të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme, dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve¹, kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim², ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

2 Hulumtimi ka gjetur se ka një konflikt ndërmjet Ligjit të Prokurimit Publik (Neni 108/A), dhe Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik (Neni 43).

Neni 108/A i LPP thotë:

Zgjidhja preliminare e mosmar-rëveshjeve

3 Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së NJOFTIMIT PËR DHËNIEN E KONTRATËS ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

Ndërsa, sipas Nenit 43 të RrOUPP, ky afat fillon nga data e publikimit të Formularit B58 – Njoftimit mbi Vendimin e AK.

3 3. Në mungesë të udhëzimeve të mirëfillta nga KRPP lidhur me tenderët për shërbime, respektivisht si të adresohen në Paramasë të dosjes së tenderit detyrimet nga ligji i punës, si dhe kostoja administrative, logjistike dhe fitimi, Komuna e Ferizajt kishte pranuar një ofertë prej 224€ për çdo punëtor që do të paguhej 270€ bruto, pa e definuar se çfarë do të mbuloj kjo shumë, ndërsa Komuna e Lipjanit kishte pranuar një ofertë që mbulonte vetëm rrogat e

1 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

2 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik



punëtorëve, dhe nuk përmbushte asnjë detyrim nga ligji i punës, si dhe kostot përcjellëse (indirekte) të shërbimit në fjalë. Për më shumë, Lipjani kishte bërë edhe gabime aritmetikore në kalkulimin e stafit të nevojshëm kundrejt orëve të tenderuara, me ç' rast tek ky tender i komunës është vërejtur një dallim prej **360** orë më pak në këtë të fundit, e që rrjedhimisht rrezikonte që komuna të mbetej pa shërbime, ose kompania performuese të zhytej në detyrime të pambulueshme nga vlera e kontratës.

4 Gjithashtu, në mungesë të kërkesave të standardizuara për kategoritë e prokurimeve publike, komuna e Podujevës në tenderin për asfaltimin e rrugëve Shajkofc dhe Batllavë, Sfaqël dhe Ballofc, dhe Livadicë, Lladofc dhe Surkish të komunës së Podujevës nuk kishte definuar kapacitetet motoriste të nevojshme për implementimin e kontratës, duke rrezikuar që kontratën të fitonin kompani të cilat nuk kishin kapacitete të mjaftueshme, respektivisht duke rrezikuar kualitetin apo kohëzgjatjen e punëve.

5 Tek komuna e Ferizajt, për shkak të mungesës së një hulumtimi të mirëfilltë të tregut, kontrata për ndërtimin e rrugëve në Tërë dhe dhënë në vitin 2017 kishte rezultuar për 30.86% më e vogël se vlera e parashikuar, përderisa disa rrugë kishin mbetur ma u përfshirë në kontratë. Në vitin 2019, komuna kishte nënshkruar një aneks kontratë prej rreth 8.9% të vlerës së kontratës bazë. Sikur komuna të kishte bërë një hulumtim të tregut dhe një analizë të mirëfilltë të nevojave, kjo aneks kontratë do të kishte mundur të akomodohej brenda shumës së mbetur ndërmjet planifikimit dhe vlerës së kontratës.

6 Tek tenderi për furnizim me zhavorr i Komunës së Prizrenit ishin identifikuar probleme të ndryshme. Vlera e buxhetuar për këtë shërbim ishte 250,000.00 EURO, megjithatë në planifikimin e prokurimit, ko-

muna kishte rritur këtë vlerë në 1.5 milion Euro, me të cilën vlerë ishte bërë edhe njoftimi për kontratë kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajve. Në vazhdim, në krahasim me tenderët e njëjtë të komunave të Prishtinës, Ferizajt dhe Gjlanit, komuna kishte përfshirë kritere në dosje të tenderit të cilat nuk përputheshin me ato të komunave të paracekura. Këto kritere ishin (1) numri i madh i punëtorëve (së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës) duke pasur parasysh angazhimin e punëtorëve sezonal në punët ndërtimore, (2) dy ulta rrafshues të tonazhit të mesëm, dhe (3) një cilindër të tonazhit të madh mbi 10 ton.

7 Kontratën për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve të komunës së Suharekës, për afër një dekadë e implementon kompania rajonale "Ekoregjioni". Pas bisedave me operatorët ekonomik të cilët kishin shkarkuar dosjen e tenderit por nuk kishin aplikuar, çmimi i këtyre shërbimeve është tejet i ulët për të investuar në makinerinë e nevojshme për implementimin e kontratës, andaj nuk paraqet interes për të tenderuar.



Për të portretizuar me sa më saktësi performancën e komunave, KDI dhe partnerët implementues u konsultuan ngushtë me legjislacionin për rregullat e prokurimit publik në Kosovë. Meqenëse ky projekt është përqendruar në dy aktivitete kryesore (trajnimi i OSHC-ve lokale dhe mbikëqyrja e komunave në planifikimin e buxhetit) KDI ndërmori disa veprime drejt krijimit të mjeteve më të mira për të paraqitur një pasqyrim të drejtë të performancës komunale. KDI siguroi një trajnim të hollësishëm për anëtarët e konsorciumit lidhur me planifikimin e prokurimeve, si dhe trajnime të vazhdueshme përgjatë procesit të monitorimit. Ndërsa për përzgjedhjen e tenderëve për monitorim, anëtarët e konzorciumit kishin shfrytëzuar burime të ndryshme si burimet mediale, ankesa të qytetarëve të publikuara në rrjete sociale dhe media lokale, ankesat në OSHP, si dhe konsultimet me aktivistë të shoqërisë civile. Për më tutje, OSHC-të lokale gjithashtu u këshilluan me udhëheqjen komunale dhe zyrën e prokurimit të komunave të Prizrenit, Suharekës, Ferizajt, Lipjanit, Podujevës dhe Istogut në lidhje me procedurat dhe veprimet për tenderët e përzgjedhur.

Si përmbledhje, ky hulumtim u bazua në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave si më poshtë:

- Përcjellja e 194 njoftimeve për kontratë³ të shpallur nga komunat në periudhën janar – qershor 2019

FERIZAJ		32
ISTOG		44
LIPJAN		57
PODUJEVË		45
PRIZREN		95
SUHAREKË		43

- Analiza e gjashtë planifikimeve të prokurimit⁴ për 2019
- Analiza e 220 vendimeve të OSHP⁵ për gjashtë komunat për përdhën 2018-2019;

3 Shpjegim: Kur një Autoritet Kontraktues synon të kryejë një aktivitet të prokurimit duke përdorur një procedurë të hapur, të kufizuar, zyra e prokurimit do të përgatisë Njoftimin e Kontratës pavarësisht nga lloji i tenderit ose vlera e tij. Kjo njihet ndryshe si një thirrje për tender

4 Shpjegim: Planifikimi i prokurimit është hapi i parë dhe është një proces i ndërmarrë nga autoritetet kontraktuese për të planifikuar aktivitetet për një periudhë prej 12 muajsh.

5 Shpjegim: Vendimet e OSHP-së janë vendime të marra nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, i njohur ndryshe si Gjykata e Tenderëve, për pretendimet e parregullsisve në proces, të paraqitura nga palët e interesuara.

- Analiza e dymbëdhjetë (12) dosjeve të tenderit;⁶
- Analiza e 68 ofertave në përgjigje të 12 njoftimeve për kontratë
- Analiza e dymbëdhjetë (12) raporteve të vlerësimit dhe dokumenteve përkatëse duke përfshirë njoftimet për vendimet e autoriteteve kontraktuese;


KOMUNA	TENDERI 1	TENDERI 2	TOTAL
FERIZAJ	1	2	3
ISTOG	4	4	8
LIPJAN	3	7	10
PODUJEVË	10	5	15
PRIZREN	10	6	16
SUHAREKË	15	1	16

- Gjashtë takime me zyrtarë të prokurimit në gjashtë komunat;
- Analiza e tre tenderëve në komunën e Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit për qëllime krahasuese;
- Konsultime me OSHC, Gazetarë dhe mbi 40 artikuj në media;
- 18 Konsultime me Operator Ekonomik pjesëmarrës në procedurat e tenderimit të përzgjedhura.

⁶ Shpjegim: Dosja e tenderit është një dokument zyrtar i përgatitur nga autoritetet kontraktuese për të gjitha thirrjet e tenderit, përveç blerjeve me vlerë minimale, dhe përcakton fushën e punës dhe afatet dhe kushtet që duhet të përmbushen nga ofruesit për atë aktivitetet të prokurimit.

ANALIZA E TENDERËVE:

KOMUNA E PRIZRENIT



Për Komunën e Prizrenit janë analizuar dy tenderë. Ndër kushtet për pjesëmarrje të cekura në dy Dosjet e Tenderit, komuna kishte kërkuar një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik⁷ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët apo udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Koalicioni, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit

duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme, dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve⁸, kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim⁹, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikant e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Një sfidë e veçantë me të cilën koalicioni ishte ballafaquar gjatë periudhës së analizimit të këtyre tenderëve është që komuna nuk pranon kërkesat përmes postës elektronike. Ato duhet të dërgohen fizikisht, dhe dokumentet të pranohen fizikisht.

Tenderi për ndërtimin e infrastrukturës rrugore në fshatin Gjonaj të Prizrenit¹⁰

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 250,000.00 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 200 ditësh. Komuna e Prizrenit kishte shpallur tenderin për ndërtimin i infrastrukturës

7 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

8 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

9 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik

10 622-18-8161-5-2-1.



Kostoja e buxhetuar për furnizimin me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara në komunën e Prizrenit ishte 250,000 për një vit. Sidoqoftë, në parashikimin e prokurimit, komuna e kishte rritur këtë kosto në 1.5 milion EUR, një rritje prej 100% për periudhën tre vjeçare.

turës rrugore në fshatin Gjonaj, me datën 22 tetor 2018¹¹. Ky tender i vlerës së mesme ishte i hapur për aplikim vetëm 15 ditë,¹² e që nuk i përmbushte kërkesat ligjore të ligjit për prokurim publik, të ishte i hapur për së paku 20 ditë¹³.

Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët "G Project SHPK" nga Prizreni, të cilët kishin ofertuar me çmimin 217,133.24 Euro.

Për këtë tender kishin aplikuar 10 kompani, dhe nga to pesë ishin shpallur të papërgjegjshme. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratën vetëm një ditë pas njoftimit për dhënien e kontratës¹⁴.

Si praktikë e mirë, është vërejtur se në këtë tender komuna nuk kishte përdorur kritere diskriminuese, të cilat do të

mund të dëmtonin konkurrencën, ndërsa për mbikëqyrje të punëve, komuna kishte kërkuar që kompania të kishte një inxhinier të diplomuar të arkitekturës, me së paku pesë vite eksperiencë pune.

Tenderi për furnizim me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit¹⁵

Vlera e buxhetuar për këtë shërbim ishte 250,000.00 EURO, megjithatë në planifikimin e prokurimit, komuna kishte rritur këtë vlerë në 1.5 milion Euro, me të cilën vlerë ishte bërë edhe njoftimi për kontratë kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajve.

Komuna e Prizrenit kishte shpallur tenderin për furnizim me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës me

11 Data e publikimit në e-Prokurimi 29 tetor 2018, edhe pse data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 22 tetor 2018, respektivisht 7 ditë më herët.

12 Data për pranimin e tenderëve 13 nëntor 2018

13 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

14 Komuna nuk kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).

15 622-19-1256-1-1-1

datën 25 shkurt 2019¹⁶. Ky tender i vlerës së madhe ishte i hapur për aplikim 40 ditë¹⁷ në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit për prokurim publik¹⁸.

Për të parë nëse kishte kritere favorizuese në dosje të tenderit, ishin konsultuar tre kontrata të tjera publike¹⁹ për të njëjtën lëmi të punës dhe për qytete të madhësisë së afërt. Ky krahasim kishte identifikuar tri kritere të dosjes së tenderit të cilat ishin vendosur në tenderin e Prizrenit, mirëpo nuk ishin në tenderët e tre qyteteve tjera, si (1) numri i madh i punëtorëve (së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës) duke pasur parasysh angazhimin e punëtorëve sezonal në punët ndërtimore, (2) dy ulta rrafshues të tonazhit të mesëm, dhe (3) një cilindër të tonazhit të madh mbi 10 ton. Komuna, fillimisht kishte kërkuar edhe që OE të ketë në pronësi apo marrëveshje bashkëpunimi me gurëthyes në një largësi jo më të madhe se 15 km nga qyteti i Prizrenit, por që kjo kërkesë ishte larguar me datën 25.04.2019, si përmirësim i dosjes së tenderit.

Për këtë tender kishin aplikuar gjashtë kompani dhe komuna e Prizrenit kishte përzgjedhur për të shpërblyer "EUROVIA" Sh.p.k. nga Prizrenit, të cilët kishin ofertuar me çmimin për njësi 20,05 Euro. Ky vlerësim ishte përcjell me ankesa nga operatorët e diskualifikuar. Me 3 qershor 2019

ky aktivitet ishte pezulluar pas ankesave nga dy operatorëve ekonomik me ofertat më të lira. Pas përgjigjes nga komuna e Prizrenit²⁰ se vendimi mbetej i njëjtë edhe pas kërkesës për ri-shqyrtim, të dy palët kanë dorëzuar apo kanë deponuar ankesa²¹ kundër vendimit të Komunës së Prizrenit në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Pas shqyrtimit nga eksperti i çështjes, OSHP kishte marr vendim²² që të aprovonte pjesërisht ankesat e dy operatorëve ekonomik, dhe kishte kërkuar nga komuna të anulonte vendimin për dhënie të kontratës²³, dhe të kthente lëndën në ri-vlerësim. Mirëpo edhe pas kthimit në ri-vlerësim, vendimet²⁴ e komunës kundrejt dy palëve ankimore kishin mbetur të njëjta.

16 Data e publikimit në e-Prokurimi 21 mars 2019, data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 18 mars 2019, respektivisht 3 ditë më herët.

17 Data për pranimin e tenderëve 30 prill 2019

18 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

19 Ferizaj: 656-19-6368-5-2-1; Gjakovë: 632-19-601-5-2-1, and (3) Prishtinë: 616-18-8757-5-2-1

20 06 qershor 2019 ju është dërguar përgjigja dy palëve ankimore


21 Ankesa e "Renelual Tahiti" Sh.p.k. e datës 13 qershor 2019, me nr. të protokollit 307/19 dhe ankesa e "G SOLUTIONS L.L.C.; G-PROJECT SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K", e datës 17 qershor 2019, me nr. të protokollit 321/19.

22 Vendimi i OSHP i datës 14 gusht 2019, me nr. të protokollit 307, 321/19

23 Deri më datën 23 tetor 2019 Njoftimi për dhënie të kontratës nuk është publikuar nga komuna në e-Prokurimi

24 Vendimi i datës 08 tetor 2019 ndaj "Renelual Tahiti" Sh.p.k. dhe vendimi i datës 09 tetor 2019 ndaj "G SOLUTIONS L.L.C.; G-PROJECT SH.P.K.; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K"

KOMUNA E SUHAREKËS



Për Komunën e Suharekës janë analizuar dy tenderë, atë për ndërtimin e rrugëve lokale në fshatrat Bllace, Bukosh, Grejkoc, Reshtan, Studenqan dhe Samadraxhë, dhe tenderi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit të Suharekës. Njëjtë sikurse në komunën paraprake edhe Suhareka në dy Dosjet e Tenderit kishte kërkuar vetëm një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik²⁵ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët ose udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Konsorciumi, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhësuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme,

dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve²⁶, kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim²⁷ ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Një shembull i mirë ishte vërejtur lidhur me respektimin e afateve ligjore për publikime dhe vlerësime. Në vazhdim, komuna kishte publikuar në e-prokurimi të gjitha dokumentet e kërkuara me ligj dhe kishte dhënë qasje në dokumentet e kërkuara brenda afateve kohore. Si dhe të dy proceset e tenderimit ishin zhvilluar pa ankesa nga palët e interesuara.

Tenderi për ndërtimin e rrugëve lokale në Komunë të Suharekës²⁸

Ky tender ishte i ndarë në gjashtë pjesë, dhe përfshinte ndërtimin e rrugëve dytësore në fshatrat Bllace, Bukosh, Grejkoc, Reshtan, Studenqan dhe Samadraxhë të komunës së Suharekës.

25 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

26 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

27 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik

28 624-19-802-5-2-1

NR. I PJESËS PËRSHKRIMI

LOT 1	Ndërtimi i rrugës Sylë Duhla, Sadri Guraziu, Ushtria e Kosovës dhe rrugët tjera në Bllacë.
LOT 2	Ndërtimi i rrugës Murat Prena ,Kadojt, Baki Izlami dhe rrugëve lokale në Bukosh
LOT 3	Ndërtimi i rrugëve lokale në Grejkoc, Përparimi, Liman Brahimi, Haxhi Isufi, Shaban Azmoni, Jakup Kurtishaj, Ali Shaqiri, Jemin Zeqiri, Brahë Zeqiri, Smajl Hyseni
LOT 4	Ndërtimi i rrugëve lokale në Reshtan ,Rifat Krasniqi, segmenti Mehmet Bytyqi, Mulliri, Milaim Gashi, Kryezive ,Kadri dhe Selman Morina, etj.
LOT 5	Lot 5 Ndërtimi i rrugës Tumat e Gurrës, Kosova, Shqiptari, Rrethojat, arat arari, Drini dhe rrugët lokale në Studenqan
LOT 6	Lot 6 Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Samadraxhë, Qershija e Cufes, ,aksi rrugor Avni Hoda, Jeton Kabashi, Shkupi dhe Pojatishtë, etj

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 335,000.00 Euro, ashtu siç edhe ishte buxhetuar për vitin 2019²⁹, me afat të përfundimit të punëve prej 60 ditësh. Sipas kushteve të caktuara në Dosjen e Tenderit, operatorët ekonomik mund të fitonin vetëm njërin nga llotet e këtij tenderi, për të cilin do të ofronin ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Me qëllim të analizimit të procesit të tenderimit, ishte përzgjedhur Lot 1, vlera e parashikuar e të cilës ishte 73,000.00 Euro. Tenderi ishte i hapur për 22 ditë pas pub-

likimit në e-Prokurimi³⁰, që tregon se komuna kishte respektuar kërkesat ligjore për minimumin prej 20 ditësh për vlerat e mesme.³¹ Për më tepër komuna kishte bërë një planifikim të mirë kohor për të akomoduar edhe afatin prej përgatitjes së dosjes së tenderit, deri në publikimin në e-Prokurimi³², pa e shkurtuar afatin në dispozicion për pranimin e tenderëve.

Një tjetër kërkesë ishte ai për kapacitetin ekonomik dhe financiar, me ç' rast për Lot 1 komuna kishte kërkuar

29 Ligji Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019: Bllacë – 73,000 Euro, Bukosh – 37,000 Euro, Grejkoc – 62,000 Euro, Reshtan – 37,000 Euro, Studenqan – 56,000 Euro, Samadraxhë – 70,000 Euro

30 Data e publikimit në e-Prokurimi 04 mars 2019

31 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

32 Dosja e tenderit ishte përgatitur me 28 shkurt 2019, dhe ishte publikuar ne e-prokurimi me datën 04 mars 2019.

dëshmi se kompania kishte qarkullim prej jo më pak se 140,000.00 €.

Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët "N.P.T. "Bamirs"" nga Suhareka, të cilët kishin ofertuar me çmimin 59,351.00 Euro.

Për këtë tender kishin aplikuar 15 kompani dhe nga to tre ishin shpallur të papërgjegjshëm. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratën tetë ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, duke treguar një praktikë të mirë të zbatimit të kërkesave të përcaktuara me ligj³³.

Në specifikat teknike, komuna nuk kishte përdorur kritere diskriminuese, të cilat do të mund të dëmtonin konkurrencën, ndërsa për mbikëqyrje të punëve, komuna kishte qenë më specifike, duke kërkuar një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore, me së paku tre vite eksperiencë pune pas diplomimit.

Tenderi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit në Komunë të Suharekës³⁴

Kontratapër mirëmbajtjen dhe pastrimin e qytetit të Suharekës ka kohë që implementimet nga i njëjti operator ekonomik, Kompania Rajonale "Ekoregjioni". Edhe pse ky është një tender i vlerës së madhe, prej 145,000.00 Euro për 12 muaj dhe dosja e tenderit ishte shkaktuar 30 herë,

në përgjigje të kësaj thirrje kishte aplikuar një kompani e vetme. Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ekoregjioni" SH.A. kishte ofertuar në shumën prej 136,295.01 Euro, dhe kjo ofertë ishte vlerësuar si e përgjegjshme nga Komisioni vlerësues³⁵.

Për këtë tender nuk kishte pasur ankesa as në fazën e tenderimit dhe as në atë të vlerësimit lidhur me specifikat apo vendimin e komunës. Konsorciumi kishte kontaktuar me disa nga kompanitë të cilët kishin shkarkuar dosjen për të pyetur se përse nuk kishin aplikuar për këtë tender.³⁶ Përgjigjet e pranuar pothuajse ishin të njëjta: Këtë kontratë ka kohë që e realizon "Ekoregjioni" të cilët posedojnë me makësinë e nevojshme dhe investimet për të hyrë në treg ishin tejet të mëdha kundrejt vlerës së kontratës, andaj nuk e shihnin të interesit për të tenderuar.

33 Komuna kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).

34 624-19-240-2-1-1.

35 Raporti i vlerësimit i datës 25 shkurt 2019

36 Komunikime të bëra me datën 06 shkurt 2020.



KOMUNA E FERIZAJT



Për Komunën e Ferizajt janë analizuar dy tenderë, ai për asfaltimin e rrugëve në fshatin Tërn dhe tenderin për sigurimin fizik të objektit të komunës. Njëjtë sikurse në dy komunat paraprake edhe Ferizaj në dy Dosjet e Tenderit kishte kërkuar vetëm një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik³⁷ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët apo udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Konsorciumi, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhësuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve³⁸, kompanitë kishin

sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim³⁹, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Në tenderin për asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave, komuna nuk kishte analizuar mirë nevojat në terren, duke krijuar nevojën që të bëhej aneks kontratë për punët të cilat kanë mundur të jenë pjesë e kontratës bazë. Po ashtu edhe tek kontrata për sigurimin fizik të objektit të komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të Komunës së Ferizajt, vlera e kontratës ishte mbi 30% më e lartë se vlera e parashikuar, e që ngritë shqetësime lidhur me mungesën e një hulumtimi të mirëfilltë të tregut.

Një shembull i mirë ishte vërejtur lidhur me shpejtësinë e trajtimit të ankesave nga Operatorët Ekonomik, të cilat komuna i kishte adresuar brenda vetëm një dite, si dhe të gjitha ankesat dhe vendimet ishin të publikuara në faqen zyrtare të komunës, si dhe në platformën e e-Prokurimit. E njëjta qasje ishte edhe ndaj kërkesave për qasje në dokumente, ku përveç përgjigjeve të shpejta, të gjitha dokumentet janë dorëzuar në formë elektronike.

37 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

38 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

39 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik





Në kontratën për siguri në ndërtesën e komunës dhe lobjektet të tjera që funksionojnë nën Komunën e Ferizajt, vlera e kontratës ishte 30% më e lartë se vlera e parashikuar, gjë që ngre shqetësime për mungesën e hulumtimit të duhur të tregut.

Tenderi për asfaltimin e rrugicave në fshatin Tërn të komunës së Ferizajt⁴⁰

Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2019, komuna e Ferizajt kishte shpallur tetë tender për infrastrukturë rrugore, të gjitha këto projekte dy dhe tre vjeçare. Fillimisht, për këtë kontratë komuna kishte të buxhetuara vetëm 20,000 Euro nga të hyrat vetanake për vitin 2017⁴¹, dhe 60,000 Euro për vitet 2018 dhe 2019. Megjithatë, gjatë implementimit të kontratës, banorët kishin shfaqur disa shqetësime, se jo të gjitha rrugët e fshatit ishin përfshirë në këtë projekt, me ç' rast komuna kishte ndarë edhe 20,000 Euro nga të hyrat vetanake për vitin 2019⁴² për përmbushjen e këtyre kërkesave.

Komuna ishte treguar e drejtë në vlerësimin e afateve kohore të nevojshme më publikim dhe ankesa. Megjithatë, komuna nuk kishte analizuar mirë çmimet e tregut e as nevojën në terren, duke krijuar nevojat për aneks kontratë për punë shtesë dhe një dallim prej mbi 30% ndërmjet

vlerës së parashikuar dhe vlerës aktuale të kontratës.

Me qëllim të monitorimit të një tenderi i cili do të realizohej gjatë vitit 2019, ishte përzgjedhur aneks kontrata⁴³ për ndërtimin e disa rrugicave në fshatin Tërn të Ferizajt. Tenderi për kontratën bazë për këtë aktivitet ishte shpallur me 08 maj 2017, me një vlerë të parashikuar prej 282,363.30 euro për periudhë dy vjeçare edhe pse sipas dosjes së tenderit kohëzgjatja për përfundimin e punëve ishte e cekur si 70 ditë⁴⁴.

Tenderi ishte i hapur për 20 ditë pas publikimit në e-Prokurimi⁴⁵, që tregon se komuna kishte respektuar kërkesat ligjore për minimumin prej 20 ditësh për vlerat e mesme⁴⁶. Komuna kishte bërë një planifikim të mirë kohor për të akomoduar edhe afatin prej përgatitjes së dosjes së tenderit, deri në publikimin në e-Prokurimi⁴⁷, pa e shkurtuar afatin në dispozicion për pranimin e tenderëve.

Për këtë tender kishin aplikuar 7 kompani dhe nga to 1

40 656-17-1873-5-2-1 dhe 656-19-4884-5-2-5

41 Ligji Nr. 05/L-125 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017

42 Ligji Nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

43 656-19-4884-5-2-5

44 Pas ndërrimit të udhëheqjes së komunës së Ferizajt, ishte ndërruar edhe udhëheqja e njësisë së prokurimit. Udhëheqësia e re nuk kishte sqarime pse ishte kjo shpërputhje ndërmjet afateve për realizimin e punëve.

45 Data e publikimit në e-Prokurimi 08 maj 2017

46 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

47 Dosja e tenderit ishte përgatitur me 04 maj 2017, dhe ishte publikuar në e-prokurimi me datën 08 maj 2017.

ishite shpallur e papërgjegjshme. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratën tetë ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, duke përmbushur kërkesat minimale të përcaktuara me ligj⁴⁸.

Në specifikat teknike, komuna kishte kërkuar një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore, me së paku tre vite eksperiencë pune pas diplomimit, si dhe një gjeodet, por nuk kishte specifikuar asnjë kapacitet motorist të cilin duhej të posedonte kompania për realizimin e punëve. Specifikat teknike të mangëta, të cilat nuk kërkojnë as një plan të mobilizimit të makinerisë së nevojshme, krijojnë mundësi për aplikim nga kompanitë të cilat nuk kanë kapacitetet realizuese.

Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët "Eskavatori" Sh.p.k. nga Ferizaj, të cilët kishin ofertuar me çmimin 195,203.50 Euro. Dallimi ndërmjet vlerës së parashikuar dhe vlerës së kontratës ishte 87,159,80 euro (30.86% më e vogël), që tregon se komuna nuk kishte bërë një hulumtim të mirëfilltë të çmimeve të tregut. Por ky nuk ishte i vetmi problem me planifikimin e këtij tenderi. Pas fillimit të punëve banorët e fshatit Tërn kishin reaguar rreth një numri të rrugicave të cilat nuk ishin përfshirë në kontratë për asfaltim. Si rrjedhojë, me 20 maj 2019, njësia implementuese kishin kërkuar nga zyra e prokurimit të bëhej një aneks kontratë për të akomoduar kërkesat e banorëve. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me 11 korrik 2019 zyra e prokurimit kishin nënshkruar një aneks kontratë në vlerë prej 17,533.25 Euro (respektivisht 8.98% të vlerës së kontratës bazë) për

asfaltimin e rrugës "Misini" dhe një rrugice shtesë. Çmimet për njësi për negocimin e kësaj kontrate ishin marr nga kontrata bazë.

Tenderi për sigurimin fizik të objektit të Komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të komunës së Ferizajt⁴⁹

Në shtator të vitit 2018, komuna e Ferizajt kishte shpallur tenderin⁵⁰ për shërbimet e sigurimit fizik të objektit të Komunës dhe objekteve të tjera të cilat funksionojnë në kuadër të komunës së Ferizajt. Vlera e parashikuar e kësaj kontrate ishte 300,000.00 Euro, në një kohëzgjatje prej 24 muajve, për 34 punëtor.

Pas publikimit të njoftimit për kontratë, komuna kishte publikuar dy herë⁵¹. korrigjime të gabimeve në dosjen e tenderit. Korrigjimi i parë ishte lidhur me mënyrën e dorëzimit të tenderëve, ku në dosjen origjinale nuk ishte specifikuar data dhe mënyra e aplikimit, ndërsa në korrigjimin e dytë ishin shtuar kërkesat e përshtatshmërisë, përshtatshmërisë profesionale, kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe kapacitetin teknik dhe profesional. Korrigjimi i dytë kishte ardhur pas ankesës nga "K.S. Besa Security" Sh.p.k. që në kushtet e përshtatshmërisë profesionale të shtohet kërkesa për ofrimin e shërbimeve të dëshmuara me licencë, raport dhe foto, edhe pse në përgjigjen e saj, komuna kishte theksuar se një kërkesë e tillë nuk do të përfshihej meqë mjaftonte vetëm licenca themelore për sigurim fizik e lëshuar nga MPB.

Përfundimisht, për këtë tender kishin aplikuar dy kompani,

48 Komuna kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).

49 656-18-6854-2-1-1.

50 Data e publikimit në e-Prokurimi 17 shtator 2018

51 Formularët standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara i datës 27 shtator 2018 dhe datës 22 tetor 2018.

dhe pas vlerësimit të ofertave, komuna kishte shpallur të pa përgjegjshme kompaninë "Nazeri 2000" sh.p.k⁵². Ndaj këtij vendimi, OE kishte dërguar ankesë në komunë⁵³. Një ditë pas, komuna refuzuar ankesën⁵⁴ e OE "Nazeri 2000" i cili ndaj kësaj përgjigje kishte deponuar një ankesë në OSHP me datën 9 nëntor 2018. Vlerësimi i komunës ishte mbështetur edhe nga eksperti i rastit, i cili konfirmon se OE, në kundërshtim me ligjin për prokurim publik kishte modifikuar paramasën dhe specifikimin e Dosjes së Tenderit, si dhe nuk kishte përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë. Me këtë rast OSHP kishte vërtetuar vendimin e komunës⁵⁵ dhe kishte rekomanduar të vazhdohej me nënshkrimin e kontratës. Edhe gjatë analizimit të ofertave, ishte konstatuar se oferta e "Nazeri 2000" nuk i kishte përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

Kontrata ndërmjet KK Ferizaj dhe grupit të OE "Skyfter-at-Live" Sh.p.k. dhe "Commando" Sh.p.k. ishte lidhur me 22 janar 2019 në vlerë prej 403,204.56 Euro për periudhën prej 24 muajve. Kur krahasojnë vlerën e parashikuar me vlerën e kontratës kornizë, shohim se komuna nuk kishte bërë paralogaritje të mirëfillta, meqë vlera e kontratës ishte rreth 30% më e lartë se ajo e parashikuar⁵⁶.

Në paramasën e publikuar nga komuna, përveç çmimeve për njësi ishte kërkuar që operatori ekonomik të paguante pagën minimale prej 270€, si dhe të kishte parasysh të gjitha obligimet të cilat rrjedhin nga Ligji i Punës. Në përmbushje të këtyre detyrimeve kompania fituese kishte ofertuar me një çmim prej rreth 494€ për punëtor, që i bie që kompania kishte paraparë rreth 224€ si koston adminis-

trative dhe fitim.

(Vlera totale e kontratës 403,204.56 / 24 muaj të kontratës = 16,800.19 / 34 punëtor = 494.12€/muaj)

Komuna ishte treguar e drejtë në vlerësimin e afateve kohore të nevojshme për publikime dhe tenderim⁵⁷, si dhe trajtimin e ankesave.

52 Njoftimi me letër standard i datës 29 tetor 2018.

53 Ankesa e datës 31 tetor 2018

54 Vendimi i komunës i datës 1 nëntor 2018


55 Vendimi i OSHP-së i datën 03 janar 2019, me nr. të protokollit 644/18

56 Sipas udhëzimit të datës 26 tetor 2018, nga Zyrtari Kryesor Financiar se meqë kemi të bëjmë me një kontratë kornizë për 24 muaj, dhe pagesa është në baza mujore, mund të vazhdohet me nënshkrimin e kontratës pa zotim të ri të mjeteve, dhe se pjesa tjetër e mjeteve do të përmbusheshin nga ndarja buxhetore për vitin 2020.

57 Data e publikimit në e-Prokurimi 17 shtator 2018, dhe data për pranimin e tenderëve 24 tetor 2019, respektivisht 40 ditë për procedurë të vlerës së madhe.



KOMUNA E LIPJANIT



Për Komunën e Lipjanit janë analizuar dy tenderë, atë për asfaltimin e rrugës Gadime e Epërme – Gllavicë dhe tenderin për sigurimin fizik të institucioneve komunale.

Njëjtë sikurse në tre komunat paraprake edhe Lipjani në dy Dosjet e Tenderit kishte kërkuar vetëm një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik,⁵⁸ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët ose udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Konsorciumi, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhësuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Neni 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme dhe trajtojnë dy sit-

uata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve⁵⁹, kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim⁶⁰, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepe penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Tenderi për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë Sociale, arkivit të qytetit, shtëpisë së kulturës dhe shtëpisë së komuniteteve ishte përcjell me probleme të ndryshme. Kishte një diskrepancë ndërmjet numrit të punëtorëve të kërkuar dhe orareve të angazhimit dhe përkthimit të këtyre shërbimeve në orë punë. Sipas orareve dhe numrit të punëtorëve të kërkuara në II.1.5 të Dosjes së Tenderit dhe sasive të përshkruara në seksionin e paramasës, është vërejtur një dallim prej 360 orë më pak në këtë të fundit, e që rrjedhimisht rrezikonte që komuna të mbetej pa shërbime ose kompania performuese të zhytej në detyrime të pambulueshme nga vlera e kontratës. Në vazhdim, komuna nuk kishte paraparë përmbushjen e obligimeve nga Ligji i Punës për sa i përket pushimeve gjatë javës, festave, pushimet vjetore dhe pushimet mjekësore të mundshme, koston e logjistikës dhe operativën, uniformat verore dhe dimërore, koston e licencimit të punëtorëve, etj., të cilat do të duhej të ofertoheshin si kosto administrative e operatorit ekonomik. Për më shumë, komuna nuk kishte vlerësuar ofertat nëse çmimet e ofertuara do të përmbushnin kërkesën nga Dosja e Tenderit për pagën minimale prej 200.00 në muaj, por kishin vendosur

58 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

59 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

60 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik



të shpërblenin ofertën me çmimin më të lirë. Ndaj këtij vendimi fillimisht kishte pasur tre ankesa në OSHP, ku në rastin e parë edhe eksperti i OSHP-së kishte dështuar të adresonte ankesat në çështjen e përgjegjshmërisë së ofertës së përzgjedhur. Kjo lëndë ishte kthyer dy herë në ri vlerësim nga OSHP, dhe si përfundim ishte anuluar në mungesë të ofertave të përgjegjshme.

Në vazhdim, komuna kishte publikuar në e-prokurimi të gjitha dokumentet e kërkuara me ligj, dhe kishte dhënë qasje në dokumentet e kërkuara brenda afateve kohore.

Tenderi për asfaltimin e rrugës Gadime e Epërme – Gllavicë në Komunën e Lipjanit⁶¹

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 59,000.00 Euro, aq sa edhe ishte buxhetuar për vitin 2019⁶², me afat të përfundimit të punëve prej 60 ditësh.

Komuna e Lipjanit kishte shpallur tenderin për asfaltimin e rrugës Gadime e Epërme – Gllavicë, me datën 2 mars 2019⁶³. Ky tender i vlerës së mesme ishte i hapur për aplikim 20 ditë⁶⁴ e me ç’ rast komuna kishte respektuar afatet e përcaktuara në ligjin për prokurim publik⁶⁵.

Ndër kushtet për pjesëmarrje të cekura në Dosjen e Tenderit, komuna kishte kërkuar vetëm vërtetimin nga gjykata ekonomike se kompania nuk ishte në proces të falimentimi. Në këtë rast, komuna nuk kishte kërkuar dy dokumentet mbështetëse⁶⁶ siç kërkohet me ligj, njëren që nuk janë të dënuar për vepra penale dhe e dyta për falimentim. Komuna gjithashtu nuk kishte kërkuar dëshmi të përbushjes së obligimeve tatimore ndaj komunës, që do të ndihmonte komunën në inkasimin e borxheve.

Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët “Berisha Company SH.A.” nga Ferizaj, të cilët kishin ofertuar me çmimin 53,893.31 Euro.

Për këtë tender kishin aplikuar tre kompani dhe të gjitha ishin vlerësuar të përgjegjshme. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratën katër ditë pas njoftimit për dhënien e kontratës⁶⁷. Në specifikat teknike, komuna kishte kërkuar një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose infrastrukturë rrugore, me së paku tre vite eksperiencë pune pas diplomimit, një gjeodet dhe së paku pesë punëtorë. Sa i përket makinerisë, nuk ishin vërejtur kërkesa të cilat do të mund të dëmtonin konkurrencën.

61 613-19-1259-5-2-1

62 Ligji Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

63 Data e publikimit në e-Prokurimi 2 mars 2019 edhe pse data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 15 mars 2019, respektivisht 7 ditë më herët.

64 Data për pranimin e tenderëve 11 prill 2019

65 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.1) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë.

66 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

67 Komuna nuk kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).

Tenderi për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë Sociale, arkivit të qytetit, shtëpisë së kulturës dhe shtëpisë së komuniteteve në Komunën e Lipjanit⁶⁸

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 200,000.00 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 36 muajve.

Komuna e Lipjanit kishte shpallur tenderin për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve komunale, ndërtesat e administratës, Qendrës për punë Sociale, arkivit të qytetit, shtëpisë së kulturës dhe shtëpisë së komuniteteve në Komunën e Lipjanit, me datën 3 dhjetor 2018⁶⁹. Ky tender i vlerës së madhe ishte i hapur për aplikim vetëm 36 ditë⁷⁰ e me ç’ rast komuna nuk kishte respektuar afatet e përcaktuara në ligjin për prokurim publik që tenderi të ishte i hapur së paku 40 ditë për aplikim⁷¹.

Ky tender, qysh në publikim kishte probleme të ndryshme. Tek përshkrimi i shkurtër i lëndës, komuna kishte definuar numrin e punëtorëve dhe oraret e angazhimit të tyre në përmbushje të këtij shërbimi.

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës

LLOT 1

- 1** Sigurimi i ndërtesës të Komunës me dy punëtorë gjatë orarit të punës dmth nga ora 8 në ora 16, çdo ditë, 2 punëtorë
- 1.1** Autoparku (oborri) dhe rampa 24 orë në ditë në javë, 4 punëtorë
- 2** Administrata komunale dhe pesë drejtoritë të lokalet e EUROKOS, pronësi e komunës, një pikë për 24 orë në ditë, 7 ditë në javë, 4 punëtorë
- 3** Qendra për punë sociale një pikë për 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, 4 punëtorë
- 4** Arkivi i qytetit nga ora 16 – 8 të mëngjesit çdo ditë pune, ndërsa në ditët e pushimit dhe festave zyrtare sigurimi 24 orë, 3 punëtorë
- 5** Shtëpia e kulturës “Tahir Sinani” nga ora 16 – 8 të mëngjesit çdo ditë pune, ndërsa në ditët e pushimit dhe festave zyrtare sigurimi 24 orë, 3 punëtorë

LLOT 2

Shtëpia e komuniteteve nga ora 16 – 8 të mëngjesit çdo ditë pune, ndërsa në ditët e pushimit dhe festave zyrtare sigurimi 24 orë, 3 punëtorë

68 613-18-9147-2-1-1

69 Data e publikimit në e-Prokurimi 3 dhjetor 2019, ndërsa data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 30 nëntor 2018.

70 Data për pranimin e tenderëve 11 prill 2019

71 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.1) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë.

Në vijim, tek pjesa II.2) e DT, komuna kishte definuar sasitë e nevojshme në orë:

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opSIONET nëse aplikohen)

Gjithsej orë pune për 3 vite

Administratë komunale, ndërtesa e komunës
11,808

ADMINISTRATA 2 te objekti i ri te EUOKOS
26,280

QPS
26,280

Oborri i administratës kryesore të Komunës, te laura
26,280

Shtëpia e kulturës
20,352

Arkivi i qytetit
20,352 llot 1

Shtëpia e komuniteteve
20,352 llot 2

Gjatë kalkulimit të orëve sipas angazhimit ditor, ishte vërejtur se DT kishte mos përputhje kundrejt kërkesave sipas numrit të punëtorëve dhe orarit të punës të punës.

LLOT 1:

1) **Ndërtesa e Komunës:** 2 punëtor x 8 orë pune x (5 ditë pune x 52 javë x 3 vite) = 2 punëtor x 8 orë pune x (261 ditë pune/vit x 3 vite) = 2 punëtor x 8 orë pune x 783 ditë pune = **12,528 orë pune për tre vite**

1.1) **Autoparku dhe rampa:** 3 punëtorë x 8 orë x 365 ditë x 3 vite = **26,280 orë për tre vite.**

2) **Administrata Komunale (EUOKOS):** 3 punëtorë X 8 orë X 365 ditë X 3 vite = **26,280 orë për tre vite.**

3) **Qendra për punë sociale:** 3 punëtorë x 8 orë x 365 ditë x 3 vite = **26,280 orë për tre vite.**

4) **Arkivi i qytetit:** 2 punëtor x ((8 orë pune x ((5 ditë pune x 52 javë x vite) - (11 ditë festa zyrtare në vit x 3 vite)) + (24 orë pune x (104 ditë të fundjavave + 11 ditë të festive zyrtare x 3 vite))) = **20,232 orë pune për tre vite**

5) **Shtëpia e Kulturës:** 2 punëtor x ((8 orë pune x ((5 ditë pune x 52 javë x 3 vite) - (11 ditë festa zyrtare në vit x 3 vite)) + (24 orë pune x (104 ditë të fundjavave + 11 ditë të festive zyrtare x 3 vite))) = **20,232 orë pune për tre vite**

LLOT 2:

Shtëpia e komuniteteve: 2 punëtor x ((8 orë pune x ((5 ditë pune x 52 javë x vite) - (11 ditë festa zyrtare në vit x 3 vite)) + (24 orë pune x (104 ditë të fundjavave + 11 ditë të festive zyrtare x 3 vite))) = **20,232 orë pune për tre vite**

|||||

Dallimi ndërmjet kërkesave për nga numri i punëtorëve sipas paramasës, është si në vijim:
dhe angazhimi në ditë dhe orët e kërkuara nga komuna

#	LOKACIONI I SHËRBIMIT	ORËT E KËRKUARA NGA KOMUNA SIPAS DT DHE PARAMASËS	ORËT E PUNËS SIPAS NUMRIT TË PUNËTORËVE DHE ANGAZHIMIT NË DITË (DT)	DALLIMI
LOT 1				
1	Ndërtesa e Komunës	11,808	12,528	-720
1.1	Autoparku dhe rampa	26,280	26,280	0
2	Administrata Komunale (EUROKOS)	26,280	26,280	0
3	Qendra për punë sociale:	26,280	26,280	0
4	Arkivi i qytetit	20,352	20,232	120
5	Shtëpia e Kulturës	20,352	20,232	120
LOT 2				
1	Shtëpia e komuniteteve	20,352	20,232	120
TOTAL		151,704	152,064	-360

Në linjat 1 – 3 të Lot 1, komuna kishte paraparë nga një punëtorë më shumë për të përmbushur detyrimet e pushimeve të dala nga ligji i punës. Megjithatë, përderisa një

(1) punëtor është punëtorë i cili gjatë vitit bën zëvendësime për pushimet vjetore, festat dhe pushimet tjera, që mendoj se nuk mjafton për ti mbuluar. Sepse një punëtor

|||||

duke i pasur në konsideratë vetëm ditët e pushimit (rreth 20 ditë) dhe të festave (12) në vend të punës mund të jetë më së shumti 228 ditë (1824 orë) (edhe pse paguhet për 52 javë x 5 ditë = 260 ditë) sepse për 3 punëtor për 3 vite ky numër i orëve arrin $3 \times 1,824 = 16,416$; pra mbesin pa mbulesë edhe 9,846 orë për 3 vite apo rreth 3,288 orë brenda vitit që do të thotë rreth 1.8 punëtor rezervë. Ndërsa në linjat 4 dhe 5 të Lot 1 dhe Lot 2, komuna nuk kishte paraparë punëtorë shtesë për zbatimin e detyrimeve nga ligji i punës. Megjithatë, komuna kishte mbi kalkuluar nga 15 ditë punë shtesë në këto tre linja (120 orë shtesë / 8 orë punë = 15 ditë pune), të cilat përsëri nuk përmbushin nevojat për zbatimin e pushimeve vjetore dhe mjeksore siç parashihen me ligjin e punës.

Për më shumë, në përshkrimin e çmimeve komuna nuk kishte paraparë përmbushjen e obligimeve nga Ligji i Punës për sa i përket pushimeve gjatë javës, festave, pushimet vjetore dhe pushimet mjeksore të mundshme, koston e logjistikës dhe operativën, uniformat verore dhe dimërore, koston e licensimit të punëtorëve, etj., të cilat do të duhej të ofertoheshin si kosto administrative e operatorit ekonomik.

Një e metë tjetër ishte që përshkrimi i çmimeve kërkonte çmimin bazë dhe shumën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (18%) dhe duke mos paraparë koston operative, nuk trajtonte tatimet mbi të ardhurat dhe kontributet e punëdhënësit, duke krijuar mundësinë për detyrime shtesë për kontraktorin, e që do të rrezikonin kualitetin e realizimit të kontratës.

Me 17 dhjetor 2018, komuna kishte publikuar formularin standard për korrigjimin e gabimeve, me ç' rast komuna kishte rritur vlerat e parashikuara si në vijim:

VENDI I TEKSTIT I CILI DUHET TË MODIFIKOHET:	NË VEND TË:	ËSHTË:
Vlera e parashikuar e kontratës	151,700.00	200,000.00
Vlera e parashikuar ne lloje te ndara per llot 1	131,700.00	150,000.00
Vlera e parashikuar ne lloje te ndara per llot 2	20,000.00	30,000.00

Edhe në këtë korrigjim, komuna kishte bërë gabim, duke mos përllogaritur mirë vlerën totale të parashikuar (**LOT 1 – 150,000 + LOT 2 30,000 = 180,000**).



Për këtë tender kishin aplikuar shtatë operator ekonomik, me ç' rast pas vlerësimit të ofertave, tre ishin shpallur të papërgjegjshëm⁷². Komuna kishte vlerësuar që për Lot 1 të shpërblente "Delta Security" Sh.p.k. të cilët kishin ofertuar me çmimin më të lirë në vlerë totale prej 166,817.04 Euro, ndërsa për Lot 2 "Commando" Sh.p.k. në vlerë prej 25,847.04.

Menjëherë pas vendimit të komunës⁷³, kishte pasur reagime nga pjesëmarrësit në proces. "Alfa Private Security" Sh.p.k. dhe "International Security Association" Sh.p.k. ishin ankuar pranë autoritetit kontraktues lidhur me përgjegjshmërinë e ofertës së përzgjedhur nga komuna, si dhe kjo e dyta edhe kundër vendimit të komunës për ta

shpallur të papërgjegjshëm⁷⁴. Komuna kishte refuzuar të dy ankesat⁷⁵, me ç' rast të dy kompanitë kishin deponuar ankesa në OSHP, nën të njëjtat dyshime. Eksperti i OSHP-së⁷⁶ kishte dështuar në aderimin e ankesës duke trajtuar vetëm kriterin e çmimit më të ulët dhe jo përgjegjshmërinë e ofertës së përzgjedhur, ndaj të cilës edhe ishin ngritur dyshimet. Eksperti kishte mbështetur ekspertizën e tij në bazë të deklaratës së ofertuesit se do t'i përmbahet pagës bruto prej 200.00 Euro në muaj.

Sipas një analize të thjeshtë, pa asnjë fitim nga kompania, dhe pa koston administrative dhe operative, oferta minimale për Lot 1 do të duhej të ishte si në vijim

#	PËRSHKRIMI	NJËSIA
1	Nr. i Punëtorve	20
2	Paga për muaj	€ 200.00
3	Kohëzgjatja në muaj	36
4	Paga Bruto (1*2*3)	€ 144,000.00
5	5% kontributi i punëdhënësit	€ 7,200.00
6	TVSH 18% (kompania)	€ 27,216.00
TOTAL (4+5+6)		€ 178,416.00

72 1) "SFK" Sh.p.k., 2) "Rosa-security" Sh.p.k., dhe 3) "Internat Security Association" Sh.p.k.

73 Vendimi i datës 09 janar 2019

74 Ankesat e datës 10 janar 2019

75 Vendimi i komunës i datës 30 janar 2019

76 Vendimi i OSHP-së i datës 19 mars 2019, me numër të protokollit 46/19, 49/19



Paneli shqyrtues kishte vendosur të kthente në ri-vlerësim tenderin në fjalë dhe kishte kërkuar nga Autoriteti Kontraktues të vlerësonte nëse oferta e "Besa Security" Sh.p.k. mund të përmbushte kërkesën për pagën minimale në vlerë prej 200.00€ në muaj.


Pas ri-vlerësimit, komuna kishte mbajtur të njëjtin vendim, me ç' rast "International Security Association" Sh.p.k. kishte deponuar përsëri një ankesë në OSHP, nën pretendimin se komuna nuk kishte respektuar kërkesën e OSHP të vlerësonte nëse oferta e për zgjedhur mund të përmbushte pagën minimale prej 200.00€. Në ankesën e dytë, po i njëjti ekspert shqyrtues kishte rekomanduar që lënda të shkoj përsëri në ri vlerësim meqë komuna nuk kishte zbatuar vendimin paraprak të OSHP-së. Komisioni shqyrtues përsëri kishte vendosur që të anulonte njoftimin për dhënie të kontratës, dhe të dërgonte lëndën në ri-vlerësim⁷⁷.

Me datën Komuna kishte anuluar aktivitetin e prokurimit për Lot 1, nën arsyetimin se nuk kishte asnjë ofertues të përgjegjshëm. Tre ofertues nuk kishin përmbushur kriteret e përshtatshmërisë, ndërsa katër ofertuesit të tjerë kushtin për pagë mujore në vlerë prej 200.00€.

Komuna gjithashtu nuk kishte kërkuar dëshmi të përmbushjes së obligimeve tatimore ndaj komunës, që do të ndihmonte komunën në inkasimin e borxheve.

⁷⁷ Vendimi i OSHP-së i datës 21 maj 2019, me numër të protokollit 178/19

KOMUNA E PODUJEVËS



Për Komunën e Podujevës janë analizuar dy tenderë. Në të dy rastet komuna ishte treguar e drejtë në vlerësimin e afateve kohore të nevojshme për publikim dhe ankesa, mirëpo jo edhe për vlerësimin e ofertave. Në kontratën për ndërtimin e serave për fermer, komuna kishte përfunduar vlerësimin e ofertave me 21 ditë vonesë nga afati i fundit prej 30 ditësh, siç e definon ligji. Në këtë rast hapja ishte bërë me 3 prill 2019 ndërsa vlerësimi i ofertave ishte bërë me datën 24 maj 2019. Njëjtë sikurse tek komunat para-prake edhe Podujeva tek tenderi për asfaltimin e rrugëve kishte kërkuar vetëm një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik⁷⁸ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët dhe udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Konsorciumi, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhësuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk

jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve⁷⁹, kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim⁸⁰, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Komuna kishte treguar një shembull të mirë të publikimit në e-prokurimi të gjitha dokumentet e kërkuara me ligj, si dhe kishte dhënë qasje në dokumentet e kërkuara brenda afateve kohore.

Tenderi për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Shajkovc, Batllavë, Svegël, Ballovc, Lladovc, Livadicë dhe Surkish në Komunën e Podujevës⁸¹

Ky tender ishte i ndarë në tre pjesë dhe përfshinte ndërtimin e rrugëve ndërlidhëse të fshatrat Shajkovc dhe Batllavë, Svegël dhe Ballovc dhe Livadicë, Lladovc dhe Surkish të komunës së Podujevës.

78 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

79 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

80 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik

81 615-19-611-5-2-1.

**NR. I PJESËS****PËRSHKRIMI****LOT 1**

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Shajkofc, Batllavë

LOT 2

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Sfeqël, Ballofc

LOT 3

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Livadicë, Lladofc dhe Surkish

Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 446,744.00 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 70 ditësh. Si-pas kushteve të caktuara në Dosjen e Tenderit, operatorët ekonomik mund të fitonin vetëm njërin nga llotet e këtij tenderi, për të cilin do të ofronin ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Me qëllim të analizimit të procesit të tenderimit, ishte përzgjedhur Lot 1, vlera e parashikuar e të cilës ishte 141,596.57 Euro. Tenderi ishte i hapur për 21 ditë pas publikimit në e-Prokurimi⁸², që tregon se komuna kishte respektuar kërkesat ligjore për minimumin prej 20 ditësh për vlerat e mesme⁸³. Për më tepër komuna kishte bërë një planifikim të mirë kohor për të akomoduar edhe afatin prej përgatitjes së dosjes së tenderit, deri në publikimin në e-Prokurimi⁸⁴, pa e shkurtuar afatin në dispozicion për pranimin e tenderëve.

Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët "Papenburg" nga Ferizaj, të cilët kishin ofertuar me çmimin 136,626.38 Euro.

Për këtë tender kishin aplikuar 10 kompani dhe nga to tre ishin shpallur të papërgjegjshme. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratës pesë ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, duke respektuar kërkesat minimale të përcaktuara me ligj⁸⁵.

Në specifikat teknike, komuna kishte kërkuar një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv ose in-frastrukturë rrugore, me së paku tre vite eksperiencë pune pas diplomimit, si dhe një inxhinier i diplomuar ose me bachelor të gjeodezisë, me së paku një vit përvojë pune. Komuna, nuk kishte specifikuar asnjë kapacitet motorist të

82 Data e publikimit në e-Prokurimi 04 mars 2019

83 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

84 Dosja e tenderit ishte përgatitur me 21 shkurt 2019, dhe ishte publikuar në e-Prokurimi me datën 25 shkurt 2019.

85 Komuna kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).





cilin duhej të posedonte kompania për realizimin e punëve, duke kërkuar vetëm që kompania duhet të posedojë mjetet e domosdoshme për realizimin e punëve. Kërkesat e mangëta, të cilat nuk kërkojnë as një plan të mobilizimit të makinerisë së nevojshme, krijojnë mundësi për aplikim nga kompanitë të cilat nuk kanë kapacitetet realizuese.

Tenderi për ndërtimin e serave për fermer në Komunë të Podujevës⁸⁶

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 162,396.32 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 45 ditësh.

Komuna e Podujevës kishte shpallur tenderin për ndërtimin e 100 serave për fermer, me datën 11 mars 2019⁸⁷. Ky tender për punë, i vlerës së mesme, ishte i hapur për aplikim 22 ditë⁸⁸. Hapja e ofertave ishte bërë me 3 prill 2019 ndërsa njoftimi mbi vendimin e komunës ishte bërë me 24 maj 2019. Komuna nuk kishte ofruar qasje në raportin e vlerësimit të parë të ofertave, që e ka pamundësuar të vërtetohej nëse vlerësimi i ofertave ishte bërë pas 51 ditësh nga hapja e ofertave, respektivisht me 21 ditë vonesë kundrejt kërkesave të ligjit të prokurimit publik⁸⁹.

Në përgjigje të këtij tenderi kishin aplikuar pesë kompani dhe sipas njoftimeve të vendimit të autoritetit kontraktues, oferta më e lirë ishte diskualifikuar sepse vlera e gabimeve aritmetikore tejkalonte vlerën prej 2% të lejuar me ligj. Nga katër ofertat e mbetura, komuna kishte vlerësuar për kontratë ofertën nga NTP "Liria" nga Podujeva, në vlerë prej 119,217.00 Euro. Me datën 29 maj 2019, grupi i opera-

torëve ekonomik "PMC dhe Zauna Rrethoja" nga Prishtina kishin dorëzuar në komunë kërkesën për ri-vlerësim nën arsyen se oferta e përzgjedhur ishte e papërgjegjshme. Komuna kishte refuzuar kërkesën në fjalë me datën 31 maj 2019, si të pa bazë. Me këtë rast, i njëjti grup i operatorëve, me 7 qershor 2019 kishte deponuar ankesë në OSHP. Gjatë vlerësimit të ekspertit shqyrtues ishte konkluduar se oferta e përzgjedhur nuk përmbushte kushtet për gjendjen ekonomike dhe financiare si dhe të kapacitetit teknik dhe financiar. Andaj, OSHP kishte anuluar vendimin për dhënie të kontratës, dhe kishte kthyer lëndën në ri-vlerësim⁹⁰. Pas ri-vlerësimit të ofertave, komisioni vlerësues kishte vërtetuar se oferta e kompanisë "Liria" ishte e papërgjegjshme dhe kishin rekomanduar që me kontratë të shpërblehej oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë, ajo e grupi i operatorëve ekonomik "PMC dhe Zauna Rrethoja" në vlerë prej 132,826.70 Euro. Kontrata për këto punë ishte nënshkruar me 09 nëntor 2019.

86 615-19-942-5-2-1.

87 Data e publikimit në e-Prokurimi 11 mars 2019 dhe data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 8 mars 2019.


88 Data për pranimin e tenderëve 2 prill 2019

89 RrUOPP, Neni 41, Paragrafi 2: "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh".

90 Vendimi i OSHP-së i datës 23 korrik 2019, me numër të protokollit 289/19



KOMUNA E ISTOGUT



Për Komunën e Istogut janë analizuar dy tenderë. Komuna kishte respektuar afatet kohore të nevojshme më publikim dhe ankesa. Sikurse tek rasti i komunës së Podujevës edhe Istogu në Dosjen e Tenderit për ndërtim të rrugëve kishte kërkuar vetëm një dokument të lëshuar nga Gjykata si dëshmi të përmbushjes së kërkesave të përshtatshmërisë sipas ligjit të prokurimit publik⁹¹ se kompania nuk ishte në proces të falimentimi apo pronarët dhe udhëheqësit e saj të ishin shpallur fajtor për mashtrim nga një gjykatë kompetente. Konsorciumi, kishte gjetur se Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk jep udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme, dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve⁹², kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim⁹³, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë

dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme.

Në vazhdim, në tenderin për ndërtimin e rrugës Hul Huli, komuna nuk kishte kërkuar dëshmi të kapaciteteve teknike, respektivisht makinerinë, për përfundimin e punëve, por vetëm që kompania të posedoj makinerinë e nevojshme për realizimin e punëve, si dhe nuk kishte kërkuar një plan për mobilizimin e makinerisë, duke rrezikuar që tenderi të fitohej nga një kompani e cila nuk do të kishte kapacitete realizuese. Por, shqetësimi më i madh është lidhur me çmimet jo-normalisht të ulëta me të cilat kishte ofertuar kompania fituese për implementimin e lot 1. Oferta fituese ishte për 188.43% më e ulët se mesatarja e të gjitha ofertave për këtë Lot dhe që vë në rrezik kualitetin e punëve.

Komuna kishte publikuar në e-prokurimi të gjitha dokumentet e kërkuara me ligj, dhe kishte dhënë qasje në dokumentet e kërkuara brenda afateve kohore.

Tenderi për ndërtimin e rrugëve Hul Huli (Istog i Poshtëm), ndërtimi i rrugës Brahim Salihu Tomoc Kovrage, dhe asfaltimin e rrugës në lagjen Dekaj (Istog i Poshtëm) në Komunën e Istogut⁹⁴

Ky tender ishte i ndarë në tre pjesë, dhe përfshinte ndërtimin e rrugëve ndërlidhëse të fshatrat Hul Huli (Istog i

91 Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve

92 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

93 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik

94 633-19-2063-5-2-1

Poshtëm), ndërtimi i rrugës Ibrahim Salihu Tomoc Kovrage të komunës së Istogut.
dhe asfaltimin e rrugës në lagjen Dekaj (Istog i Poshtëm)

NR. I PJESËS**PËRSHKRIMI****LOT 1**

Ndërtimi e rrugëve Hul Huli (Istog i Poshtëm)

LOT 2

Ndërtim i rrugës Ibrahim Salihu Tomoc Kovrage

LOT 3

Asfaltimi e rrugës në lagjen Dekaj (Istog i Poshtëm)

Vlera e parashikuar për këtë kontratë ishte 90,000.00 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 60 ditësh. Sipas kushteve të caktuara në Dosjen e Tenderit, operatorët ekonomik mund të fitonin deri në tre llotet e këtij tenderi, për të cilat do të ofronin ofertën e përgjegjshme me çmimin më të lirë.

Me qëllim të analizimit të procesit të tenderimit, ishte përzgjedhur Lot 1, vlera e parashikuar e të cilës ishte 40,000.00 Euro. Tenderi ishte i hapur për 20 ditë pas publikimit në e-Prokurimi⁹⁵, që tregon se komuna kishte respektuar kërkesat ligjore për minimumin prej 20 ditësh për vlerat e mesme⁹⁶. Komuna nuk kishte paraparë vonesat e mundshme për publikim në e-prokurimi⁹⁷, duke rrezikuar shkurtimin e afatit për pranimin e ofertave.

Komuna gjithashtu nuk kishte kërkuar dëshmi të përbushjes së obligimeve tatimore ndaj komunës, që do të ndihmonte komunën në inkasimin e borxheve. Gjithashtu, komuna nuk kishte kërkuar nga ofertuesit dëshmi mbi kapacitetet ekonomike dhe financiare.

Për këtë tender kishin aplikuar katër kompani dhe të gjitha ishin shpallur të papërgjegjshme. Tenderin e kishte fituar Kompania e përgjegjshme me çmimin më të ulët "Shkambi Sh.p.k." nga Istogu, oferta e të cilëve ishte identike me vlerat e parashikuara në dosjen e tenderit. Për më shumë, dallimi ndërmjet ofertës fituese dhe ofertës së dytë më të lirë për Lot 1 ishte 65.66%. Komuna kishte kërkuar sqarime nga operatori ekonomik lidhur me çmimin jo normalisht të ulët, me ç' rast ofertuesi kishte deklaruar se kishte kapacitetet ekonomike dhe financiare.

⁹⁵ Data e publikimit në e-Prokurimi 04 mars 2019

⁹⁶ Ligji Nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092; Neni 44 - Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje; paragrafi 2: Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: (2.2) kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se njëzet (20) ditë.

⁹⁷ Dosja e tenderit ishte përgatitur me 11 prill 2019 dhe ishte publikuar vetëm pas një dite në e-Prokurimi me 12 prill 2019.

itete të mjaftueshme dhe mund të përballonte realizimin e kontratës me çmimin në fjalë. Megjithatë, një çmim i tillë tregon se komuna nuk kishte bërë një planifikim të mirëfillt të vlerës së kontratës dhe një kontratë me çmime jo normalisht të ulëta rrezikon kualitetin e punëve.

Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues, dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Komuna kishte nënshkruar kontratën pesë ditë pas publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, duke respektuar kërkesat minimale të përcaktuara me ligj.⁹⁸

Në specifikat teknike, komuna kishte kërkuar një inxhinier të diplomuar të gjeodezisë, me së paku tre vite përvojë pune. Komuna, nuk kishte specifikuar asnjë kapacitet motorist apo njerëzor të cilin duhej të posedonte kompania për realizimin e punëve, duke kërkuar vetëm që kompania duhet të posedojë mjetet e domosdoshme për realizimin e punëve. Specifikat teknike të mangëta, të cilat nuk kërkojnë as një plan të mobilizimit të makinerisë së nevojshme, krijojnë mundësi për aplikim nga kompanitë të cilat nuk kanë kapacitetet realizuese.

Vlen të theksohet se komuna kishte publikuar në e-Prokurimi të gjitha dokumentet përkatëse lidhur me tenderin në fjalë, duke përfshirë edhe raportet e vlerësimit.

Tenderi për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të rendit të IV-të në Komunën e Istogut⁹⁹

Vlera e parashikuar për këtë tender ishte 65,000.00 Euro me afat të përfundimit të punëve prej 24 muajve. Komuna e Istogut kishte shpallur tenderin për mirëmbajtjen e rrugëve lokale të rendit të IV-të, me datën 18 shkurt 2019¹⁰⁰. Ky tender për shërbime, i vlerës së mesme, ishte i hapur për aplikim 21 ditë¹⁰¹. Hapja e ofertave ishte bërë me 11 mars 2019 ndërsa njoftimi mbi vendimin e komunës ishte bërë me 23 prill 2019. Në specifikat teknike, komuna nuk kishte përdorur kritere diskriminuese, të cilat do të mund të dëmtonin konkurrencën

Për këtë tender kishin aplikuar katër kompani, dhe nga to tre ishin shpallur të papërgjegjshme. Kontrata i ishte dhënë kompanisë "Shkëmbi " Sh.p.k. nga Istogu, në vlerë prej 48,010.00 Euro, si e vetmja ofertë e përgjegjshme. Në lidhje me vlerësimin e komisionit nuk kishte pasur asnjë ankesë të deponuar në Autoritetin Kontraktues dhe as në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

98 Komuna kishte rrespektuar afatin ligjor prej 5 ditësh prej njoftimit për dhënie të kontratës deri në datën për nënshkrim të kontratës, në rast të ankesave nga palët e interesuara (Neni 108/A i LPP-së).

99 633-19-451-1-2-1

100 Data e publikimit në e-Prokurimi 18 shkurt 2019 dhe data e përgatitjes së Dosjes së Tenderit ishte 14 shkurt 2019

101 Data për pranimin e tenderëve 11 mars 2019

KONKLUZION

Analiza në fjalë pasqyron se përderisa komunat kanë vullnetin të respektojnë rregullat dhe udhëzimet e dala nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, këto rregulla, edhe pse të ndryshuara me qëllime të mira, bien ndesh me Ligjin e Prokurimit Publik. KRPP me qëllim të përshtetimit të procedurave të nënshkrimit të kontratës dhe evitimit të publikimit të shumëfishtë të Njoftimit për Dhënie të Kontratës në rast të ankesave, kishte ndryshuar legjislacionin sekondar në mënyrë që afati për ankesa të fillonte nga data e publikimit të vendimit të autoritetit kontraktues. Megjithatë, kjo bie në kundërshtim me Nenin 108/A, i cili definon se ky afat fillon nga data e publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës. Si rezultat, komunat kishin respektuar udhëzimet e KRPP-së duke shkelur dispozitat e paracaktuara në Ligjin e Prokurimit Publik.

Në vazhdim, kjo analizë ka gjetur se Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nuk japin udhëzime të mjaftueshme lidhur me përmbushjen të Nenit 65 të LPP-së, sipas të cilit ofertuesit duhet të prezantonin dy vërtetime, të cilat lëshohen nga dy gjykata të ndryshme, dhe trajtojnë dy situata të ndryshme gjithashtu. Në mungesë të këtyre udhëzimeve¹⁰², kompanitë kishin sjell vetëm vërtetimet për kërkesat lidhur me falimentim¹⁰³, ndërsa jo edhe vërtetimin që operatori ekonomik, ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara ishte shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe

ose aktivitetet e ngjashme. Kjo praktikë është dëshmuar të jetë e dëmshme, ku shoqëria civile në bashkëpunim me mediat kishin gjetur se një komunë, kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik të dënuar nga gjykata kompetente në aktakuzën e ngritur nga vet komuna¹⁰⁴.

Hulumtimi në vazhdim shpërfaq shqetësime lidhur me mungesën e standardizimit të kërkesave për kategoritë e prokurimit. Në mungesë të udhëzimeve të mirëfillta nga KRPP lidhur me tenderët për shërbime, respektivisht si të adresohen në Paramasë të dosjes së tenderit detyrimet nga ligji i punës, si dhe kostoja administrative, logjistike dhe fitimi, Komuna e Ferizajt kishte pranuar një ofertë prej 224€ për çdo punëtor që do të paguhej 270€ bruto, pa e definuar se çfarë do të mbuloj kjo shumë, ndërsa Komuna e Lipjanit kishte pranuar një ofertë që mbulonte vetëm rrogat e punëtorëve dhe nuk përmbushte asnjë detyrim nga ligji i punës, si dhe kostot përcjellëse (indirekte) të shërbimit në fjalë. Për më shumë, Lipjani kishte bërë edhe gabime aritmetike në kalkulimin e stafit të nevojshëm kundrejt orëve të tenderuara, me ç'rast tek ky tender i komunës është vërejtur një dallim prej **360** orë më pak në këtë të fundit, e që rrjedhimisht rrezikonte që komuna të mbetej pa shërbime, ose kompania performuese të zhytej në detyrime të pambulueshme nga vlera e kontratës. Po ashtu, në mungesë të kërkesave të standardizuara për kategoritë e prokurimeve publike, komuna e Podujevës në tenderin për asfaltimin e rrugëve Shajkofc dhe Batllavë, Sfeqël dhe Ballofc, dhe Livadicë, Lladofc dhe Surkish të komunës së

102 Neni 65. Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve, Paragrafi 3 dëshmitë që nuk janë të dënuar për vepra penale (Përgjegjësi e Gjykatës Themelore, Departamenti për Krime të Rënda), dhe Paragrafi 4 për falimentim (Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike).

103 Lëshohet nga Gjykata themelore e Prishtinës, Departamenti Ekonomik

104 Tenderi i kundërligjshëm i Komunës së Obiliqit, Preportr, Korrik 2019

Podujevës nuk kishte definuar kapacitetet motoriste të nevojshme për implementimin e kontratës, duke rrezikuar që kontratën të fitonin kompani të cilat nuk kishin kapacitete të mjaftueshme, respektivisht duke rrezikuar kualitetin apo kohëzgjatjen e punëve.

Po ashtu, komunat kishin probleme me planifikimin e mirëfilltë të prokurimeve dhe mungesa e hulumtimit të tregut dhe nevojës kishin rezultuar tek komuna e Ferizajt në një kontratë për 30.86% më e vogël se vlera e parashikuar, përderisa disa rrugë kishin mbetur pa u përfshirë në kontratë, e për të cilat ishte dashur të bëhej një aneks kontratë, ndërsa tek tenderi për furnizim me zhavorr i Komunës së Prizrenit vlera e buxhetuar për këtë shërbim ishte 250,000.00 EURO, megjithatë në planifikimin e prokurimit, komuna kishte rritur këtë vlerë në 1.5 milion Euro, me të cilën vlerë ishte bërë edhe njoftimi për kontratë kornizë me kohëzgjatje prej 36 muajve.

Në vazhdim, duke krahasuar tenderin e komunës së Prizrenit në krahasim me tenderët e njëjtë të komunave të Prishtinës, Ferizajt dhe Gjilanit, komuna kishte përfshirë kritere në dosje të tenderit të cilat nuk përputheshin me ato të komunave të paracekura. Këto kritere ishin (1) numri i madh i punëtorëve (së paku 20 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës) duke pasur parasysh angazhimin e punëtorëve sezonal në punët ndërtimore, (2) dy ulta rrafshues të tonazhit të mesëm, dhe (3) një cilindër të tonazhit të madh mbi 10 ton.

Hulumtimi kishte treguar se në Komunën e Sukarekës, kontratën për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve për afër një dekadë e implementon kompania rajonale "Ekoregjioni". Pas bisedave me operatorët ekonomik të cilët kishin shkarkuar dosjen e tenderit por nuk kishin aplikuar, çmimi i këtyre shërbimeve është tejet i ulët për të investuar në makinerinë e nevojshme për implementimin e kontratës, andaj nuk paraqet interes për të tenderuar.

REKOMANDIMET

- 1** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të rishikoj ndryshimet në legjislacionin sekondar për të evituar konfliktet me Ligjin për Prokurim Publik lidhur me afatet e ankesave. Aktualisht, Neni 43 i RrOUPP është në kundërshtim me Nenin 108/A të LPP, i cili definon se ky afat fillon nga data e publikimit të Njoftimit për Dhënie të Kontratës dhe jo pas njoftimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues. Meqë po i njëjti institucion është duke punuar në koncept dokumentin për ndryshim të ligjit, dispozitat lehtësuese lidhur me përshpejtimin e afateve deri në nënshkrimin e kontratës duhet të parashihen në ligj dhe pastaj të barten në RrOUPP.
- 2** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të sqaroj detyrimet që dalin nga Neni 65 i LPP-së. Duke pasur parasysh hyrjen në zbatim të deklaratës nën betim, KRPP duhet të angazhohet të siguroj një platformë të centralizuar dhe lehtë të qasshme për të gjitha Autoritetet Kontraktuese, ku ata do të mund të verifikonin nëse një kompani nuk përmbush kërkesat e përshtatshmërisë të definuara nga ky Nen i LPP-së. Koalicioni rekomandon që lista e zezë të bartet në pronësi të KRPP-së, me ç' rast KRPP do të krijojë linjë të vazhdueshme të komunikimit me organet e drejtësisë, respektivisht gjykatat dhe OSHP-në dhe të dhënat e pranuar nga këto institucione, duke përfshirë edhe afatet e sanksionimit, do të mirëmbaheshin dhe ishin të qasshme për zyrtarët e prokurimit përmes platformës së e-prokurimit.
- 3** KRPP duhet të angazhohet si në aspektin legjislativ për ta bërë të obligueshëm hulumtimin e tregut para shpalljes së tenderëve, po ashtu edhe në aspektin trajnues, për t'u siguruar që Autoritetet Kontraktuese kanë njohuritë e duhura për të arritur ekonomicitetin e tenderëve.
- 4** KRPP duhet të angazhohet në kategorizimin e specifikave sipas kategorisë së prokurimit. Paramasa për shërbime do të duhej të ishte e njëjtë për nga kërkesa dhe njësitë, në mënyrë që Autoritetet Kontraktuese të mos ballafaqoheshin me lëshime të mundshme të cilat do të mund të rezultonin në shkelje të ligjeve të fushës, apo mbi pagesës të shërbimit. Paramasa për shërbime do të duhej të ndahej në (1) çmimi për shërbimin (2) kosto indirekte si mbështetja administrative, operative, logjistike, përmbushja e detyrimeve nga ligjet përkatëse dhe fitimi. Për të evituar gabimet aritmetike, Paramasa do të duhet të zhvillohej në platformën elektronike e-Prokurimi apo si tabelë e mbyllur pa të drejtë modifikimi të formulave.
- 5** KRPP, duhet të angazhohet në monitorim më të thuktë të Njoftimeve të Publikuara dhe në rastin e identifikimit të kritereve favorizuese (të mbi ngarkuara apo nën vlerësuar) të marrin masa ndëshkuese ndaj Autoriteteve Kontraktuese.
- 6** Komunat duhet të angazhohen në përmirësimin e nivelit të planifikimit si nga aspekti i kërkesës, po ashtu edhe ai financiar, për të evituar mbi apo nën buxhetimet dhe nevojat për dhënien e aneks kontratave.

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI, ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

ID INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS